

Partia
Demokratike

GRUPI I PUNËS PËR NDRYSHIMET NË STATUT

Nr. 266 Prot.
Tiranë, më 27.05.2026

Drejtuar: Prof. Dr. Sali Berisha
Kryetar i Partisë Demokratike

Për dijeni: Kryesisë së PDSH

*I nderuar z. Kryetar,
Të nderuar anëtarë të Kryesisë,*

Grupi i Punës për Ndryshimet në Statut, i ngritur me vendimin nr. 35, datë 17.03.2026 të Kryesisë së Partisë, ka zhvilluar disa mbledhje të tij, ku ka analizuar Statutin aktual të PDSH dhe disa propozime të ardhur nga anëtarët e PD apo organizatat partnere.

Në tërësi, grupi i punës vlerësoi se Statuti i PDSH garanton funksionimin demokratik të Partisë Demokratike, respekton standardet e organizimit të partisë njëjtë me partitë kryesore simotra europiane, si dhe udhëhiqet nga parimi i rëndësishëm se “pushteti në PD i përket anëtarëve dhe jo strukturave përfaqesuese.”. Ky parim duhet ruajtur dhe zhvilluar më tej, duke e bërë Partinë Demokratike të Shqipërisë të vetmen forcë politike në vend, ku anëtari nuk është periferik, por ka një rol vendimtar në parti dhe ku vullneti i antarësisë përcakton shumëcka.

Por pavarësisht kësaj, Grupi i Punës vlerësoi se janë të nevojshme disa ndryshime në Statut, që synojnë forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe sjelljen e disa risive për t'u përshtatur me zhvillimet shoqërore në vend.

RISITË DHE NDRYSHIMET KRYESORE të propozuara, mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Fuqizimi i Diasporës shqiptare dhe përfaqësimi real politik i saj.

Partia Demokratike dhe Diaspora shqiptare nëpër botë kanë patur gjithmonë një raport të veçantë dhe një mbështetje të vazhdueshme të ndërsjelltë. Mirëpo, miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, që mundëson edhe votimin e Diasporës dikton një raport më institucional mes PD dhe shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Për këtë

arsye, është propozuar që Diaspora të ketë përfaqësim të dedikuar deri në 15 % në të gjitha organet e Partisë: Kuvendin Kombëtar, Këshillin Kombëtar dhe Kryesinë e Partisë. Gjithashtu propozohet që Diaspora të jetë e përfaqësuar në listat për deputet të PD deri në 15 % të totalit të përgjithshëm të listës së kandidatëve. Për këtë qëllim, ngritja dhe organizimi i Degëve të PD jashtë vendit, nuk është parashikuar më si një mundësi, por si një detyrim i organizimit politik dhe elektoral të Partisë.

Njohja e të drejtës së votës së diasporës krijon një realitet të ri politik ku partitë politike duhet të organizohen në mënyrë profesionale dhe afatgjatë për të ndërtuar marrëdhënie reale me emigracionin shqiptar. Partia Demokratike duhet të jetë forca e parë politike që ndërton një model modern, përfundimor dhe funksional të organizimit të diasporës shqiptare. Ne duhet ta shohim diasporën shqiptare si një fuqi ekonomike, intelektuale, kombëtare, e tashmë edhe fuqi elektorale. Prandaj është me rëndësi që Partia Demokratike ta institucionalizojë diasporën, ta përfaqësojë realisht, ta organizojë profesionalisht dhe ta kthejë në një nga shtyllat kryesore të fitores politike dhe rilindjes demokratike të Shqipërisë.

Qëllimet strategjike të ndryshimeve të propozuara në Statut janë:

- Ndërtimi i një rrjeti global politik organizativ të Partisë Demokratike në funksion të përfshirjes elektorale të diasporës në mbështetje të PD.
- Identifikimi dhe mobilizimi i votuesve shqiptarë jashtë vendit.
- Krijimi i strukturave të përhershme të PD në shtetet me përqendrimin më të madh të diasporës.
- Integrimi i elitës shqiptare jashtë vendit në vendimmarrjen politike.
- Përfaqësimi i diasporës në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.
- Ndërtimi i një sistemi modern të komunikimit dhe koordinimit ndërkombëtar.
- Krijimi i databazës kombëtare të votuesve të diasporës.

2. Fuqizimi i rolit të grave dhe vajzave në Parti

Aktualisht Statuti i PDSH garanton shanset e barabarta në pjesëmarrje dhe përfaqësim midis burrave dhe grave, duke garantuar kuotën minimale ligjore prej 30 % për gratë dhe vajzat. Mirëpo, është propozuar që kjo kuotë minimale të rritet gjer në 40 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në cdo organ apo nivel përfaqësimi, qëndror apo lokal. Kjo garanton rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në politikë.

3. Ngritjen e Komisionit të Seleksionimit të Kandidaturave për deputet dhe kryetar bashkie, si strukturë autonome nga organet drejtuese të partisë

Partia Demokratike është e vetmja forcë politike në vend që përzgjedhjen e kandidatave politike në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale, ia nënshtron votës së anëtarësisë sipas parimit “një anëtar, një votë”. Me qëllim që procesit të votimit t’i

nënshtrohen kandidaturat më të mira dhe më përfaqësuese për komunitetin, është propozuar ngritja e një strukture këshillimore, që bën vlerësim të pavarur, dhe që përfshinë edhe opinionin e jashtëm të komunitetit që nuk anagzohet në politike, duke krijuar kështu një lidhje më të fortë midis partisë dhe shoqërisë në tërësi.

4. Përmirësimi i organizimit bazë të partisë (grupseksionet dhe nëndega) dhe forcimi i Kolegjit të Kryetarëve të Grupseksioneve

Grupseksioni është struktura e ndërmjetme e organizimit bazë të partisë e cila duhet fuqizuar dhe njohur më mirë roli i rëndësishëm që luan në organizimin elektoral të PDSH. Nga ana tjetër, kryesisht në degë qendër qarku, vlerësohet e nevojshme që organizimi të jetë më eficient dhe më afër anëtarit, duke parashikuar mundësinë e krijimit të NënDegëve, me organizim dhe përgjegjësi të njëjta me Degët e Partisë. Gjithashtu, për shkak të rolit të rëndësishëm që luajnë, propozohet që kryetarët e grupseksioneve të jenë edhe anëtarë të Kryesive të Degëve.

5. Forcimi i raporteve mes Degëve të Partisë dhe të zgjedhurve vendor

Aktualisht Statuti i Partisë nuk parashikon një raport besimi dhe llogaridhënie mes të zgjedhurve vendor dhe kryesive të degëve të partisë. Ndryshe nga të zgjedhurit qendrorë që janë pjesë e kryesive të degëve, të zgjedhurit vendor (këshilltarët bashkiak) nuk përfshihen në kryesitë e degëve, duke humbur lidhjen e nevojshme që duhet të ekzistojë gjatë gjithë mandatit mes partisë dhe të zgjedhurve vendor. Për këtë qëllim, parashikohet që edhe kryetarët e këshillave bashkiak (kur i përkasin PD) apo këshilltarët bashkiak të PD, të jenë anëtarë të Kryesive të Degëve, duke garantuar vazhdimin e marrëdhënies së besimit mes partisë dhe të zgjedhurve, por duke forcuar edhe llogaridhënien e tyre në raport me interesin e qytetarëve dhe votuesve tanë.

6. Njohja e një statusi të barabratë për të gjitha organizatat partnere të partisë, duke respektuar historinë e themelimit të PDSH.

Aktualisht Statuti parashikon 3 organizata partnere të PDSH, por nuk i njeh atyre të drejta të barabrata dhe status të njëjtë përfaqësimi. Për këtë qëllim është parashikuar që edhe organizata partnere “Grupimi Dhjetori 90”, të gëzojë status të njëjtë dhe të drejtë përfaqësimi.

7. Mbrojtja e të dhënave personale të anëtarëve të Partisë

Cështja e listave të anëtarësisë së PDSH ka qenë gjithmonë objekt debati. Për këtë qëllim propozohet dixhitalizimi i tyre i plotë, përditësimi të paktën një herë në 2 vjet, si dhe forcimi i rregullave për përpunimin dhe administrimin e këtyre të dhënave, me qëllim forcimin e garancive për mbrojtjen e të dhënave personale të anëtarëve të partisë.

8. Saktësimi i rregullave të shkarkimit të kryetarëve të degëve, duke i dhënë më shumë garanci të qëndrimit në detyrë

Aktualisht Statuti i trajton shkarkimin e kryetarit të Degës nga Kuvendi i Degës si një ngjarje të zakonshme dhe jo si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Për këtë arsye, është saktësuar shumica vendimmarrëse për një rast të tillë, duke kaluar nga aplikimi i shumicës së thjeshtë, në atë të një shumicë të cilësuar.


Për të gjitha sa më sipër, lutem gjeni bashkëlidhur propozimet konkrete për ndryshime në Statutin e PDSH.

Me respekt,

GRUPI I PUNËS PËR NDRYSHIMET NË STATUT

**KRYETARI
GAZMENT BARDHI**





**Partia
Demokratike**
KUVENDI KOMBËTAR

Projekt

V E N D I M

NR. _____, DATË _____.____.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË STATUTIN E PARTISË
DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, MIRATUAR MË 11 DHJETOR 2021
DHE NDRYSHUAR MË 30 PRILL 2022**

Në mbështetje të nenit 16, shkronjës “a”, pika 1 të nenit 43 dhe nenit 63 të Statutit, me propozim të Kryesisë së Partisë Demokratike,

KUVENDI KOMBËTAR

Në mbledhjen e datës 30 Maj 2026,

V E N D O S I:

Në Statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të miratuar më 11 Dhjetor 2021 dhe të ndryshuar më 30 Prill 2022, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Pika 7, e nenit 9, riformulohet si më poshtë vijon:

“7. Shanset e barabarta në pjesëmarrje dhe përfaqësimin midis grave dhe burrave, duke synuar dhe nxitur që në cdo organ apo nivel, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave të jetë gjer në 40 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në atë organ apo nivel përfaqësimi”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

1/1. Kandidaturat e evidentuara sipas pikës 1, i nënshtrohen verifikimit dhe përzgjedhjes paraprak të Komisionit të Seleksionimit të Kandidaturave, një organ kolegjal që ngrihet me vendim të Kryesisë së PD, sa herë ka procese të seleksionimit të kandidatëve për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe/ose pushtetin vendor.

Komisioni përbëhet nga të paktën 5 anëtarë, të cilët duhet të jenë figura me një karrierë të gjatë në PD, jashtë kushteve të konfliktit të interesit, apo me angazhim të spikatur në shoqërinë civile ose botën akademike. Ata veprojnë në mënyrë të pavarur nga organet drejtuese të Partisë dhe i nënshtrohen vetëm rregullave të përcaktuara në Statut apo aktet nënligjore të miratuara në përputhje me të.

Komisioni është përgjegjës për seleksionimin paraprak të kandidatëve, bazuar në të dhënat e plotë që provojnë pastërtinë e figurës, arsimimin, aktivizimin në jetën publike dhe mbrojtjen e interesave dhe programit të PD-së, reputacionit në radhët e anëtarësisë së partisë dhe komunitetit ku jetojnë, kontributit profesional e politik në parti apo shoqëri, kontributit në fushata elektorale dhe kohëzgjatjen e anëtarësimin në parti.

Vetëm kandidatët që kalojnë me sukses filtrin e Komisionit të Seleksionimit të Kandidatëve, mund të nënshtrohen procesit sipas pikës 2 të këtij neni. Rregullat e detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Seleksionimit të Kandidaturave, si dhe për procesin që realizohet prej tyre në përzgjedhjen paraprake të kandidatëve, përcaktohen me vendim të Kryesisë së PD.

b) Në fund të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky proces duhet të kryhet dhe të ketë përfunduar jo më vonë se 6 muaj përpara datës së dekretuar zyrtarisht për zgjedhjet e përgjithshme apo vendore.”.

c) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

”4. Kryetari ose sekretari i Degës kur dëshirojnë të jenë në rrethin e kandidatëve elektorale për pushtetin qendror ose vendor, duhet t’i paraqesin dorëheqjen me shkrim Kryesisë së PD, jo më vonë se 6 muaj përpara datës së zhvillimit të procesit sipas pikës 2. Përtej këtij afati kandidatura bëhet e pakualifikueshme. Kryesia e PD ndërhyr menjëherë për të komanduar Kryetarin e ri të Degës apo për të emëruar sekretarin e ri të Degës. Kryetari apo sekretari i dorëhequr nuk mund të kandidojnë më në zgjedhjet pasardhëse për Kryetar apo sekretar të Degës.

Neni 3

Në nenin 21 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në fund të pikës 1, shtohet fjalia si më poshtë vijon:

”Regjistri i nënshtrohet procesit të përditësimit të paktën cdo dy vjet, sipas rregullave të miratuara me udhëzim të Kryesisë së PD.”.

b) Pikë 2, riformulohet si më poshtë:

”2. Të dhënat personale të cdo anëtari, përdoren vetëm për qëllime të ligjshme dhe për veprimtari brenda Partisë nga personat e autorizuar dhe sipas përgjegjësive që cakton ky Statut. Ato administrohen dhe mbrohen me standardet më të larta të sigurisë, të parshikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 26 Organizimi bazë i Partisë

1. Organizimi bazë i PD bëhet mbi bazën e njësive territoriale administrative, njësive elektorale, në nivel kombëtar mbi bazën e kriterëve specifike, ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbi bazën e rajoneve brenda një shteti apo në tërësi për një shtet.

2. Njësitë organizative të PD janë:

a) Seksionet

b) Grupseksionet

c) NënDegët e Partisë Demokratike

d) Degët e Partisë Demokratike

e) Degët e Partisë Demokratike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 5

Pika 1 e nenit 28 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Grupseksioni, ushtron veprimtarinë e tij mbi bazë njësish kompakte territoriale. Ai përbëhet nga seksionet e përfshira në territorin e ndarjes përkatëse. Si rregull, një grupseksion korrespondon me jo më pak se 5 (pesë) seksione, apo me ndarjen e rajoneve në zonat urbane, apo me ndarjen e njësive administrative në zonat rurale. Kryesia e Degës vendos për ngritjen dhe ndarjen e grupseksioneve brenda Degës, si dhe përcakton shtrirjen territoriale të tij.”.

Neni 6

Në nenin 29, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë vijon:
“3. Me vendim të Kryesisë së PDSH, brenda një Degë, mund të ngrihen dy ose më shumë NënDegë, me qëllim organizimin më të mirë të punës brenda partisë. Ato përbëhen nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura. Për aq sa është e mundur, rregullat për organizimin dhe funksionimin e Degës, janë të zbatueshme edhe për NënDegën. Raporti midis Degës dhe NënDegës, si dhe rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e NënDegës përcaktohen me udhëzim të Kryesisë së PDSH.”.

Neni 7

Neni 30 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 30

Degët e Partisë Demokratike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Kryesia e PDSH vendos krijimin e Degës së Partisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar edhe zonën apo shtetin që mbulon. Një Degë mund të mbulojë një shtet apo disa shtete. Në rastin kur ka një numër të lartë të shtetasve shqiptarë që jetojnë brenda një shteti, mund të krijohen dy ose më shumë Degë, sipas Rajoneve përkatëse.
2. Një Degë e krijuar sipas pikës 1, mund të organizohet në NënDegë, Grupseksione dhe seksione. Për aq sa është e mundur, grupseksionet i referohen një qarku brenda territorit të Shqipërisë, ndërsa seksionet njësive administrativo-territoriale. Ato duhet të mbulojnë të gjithë territorin përkatës të shtetit ku jetojnë dhe respektojnë edhe ligjet dhe rregullat përkatëse të atij shteti.
3. Degët e PD jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizohen dhe funksionojnë për aq sa është e mundur sipas rregullave që ky Statut përcakton për Degët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Organizimi dhe funksionimi i detajuar i tyre përcaktohet në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.
4. Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përfaqësohen me kandidatë në të gjitha organet drejtuese të Partisë, duke përfshirë Kuvendin Kombëtar, Këshillin Kombëtar dhe Kryesinë e PDSH-së. Ato gjithashtu përfaqësohen me kandidatët e tyre edhe në listat e Partisë Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Numri i përfaqësimit është gjer në 15 % të numrit të përgjithshëm në secilin organ apo në listë.”.

Neni 8

Në nenin 31, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Shkronja “d”, e pikës 1, ndryshon si më poshtë vijon:

“d) Drejtuesit e Departamenteve, sekretarët e Degës, si dhe Sekretari i Diasporës së Degës;”.

b) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Kuvendi i Degës së PD, me propozim të Kryesisë së PDSH, Kryesisë së Degës, ose të 1/4 së anëtarëve të tij, mund të shkarkojë sipas rastit, Kryetarin e Degës ose Kryesinë e saj, kur “pro” shkarkimit votojnë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Degës, në prani të më shumë se 2/3 së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Degës.”.

Neni 9

Në nenin 32, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e fundit, e shkronjës “a”, të pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Si anëtarë të Kryesisë së Degës me të drejta të plota mbi këtë numër përfshihen edhe kryetarët vendorë të organizatave partnere të PDSH, deputetët e PD-së të zgjedhur në territorin e Degës apo të caktuar nga Kryesia e PDSH-së për të mbulur territorin e Degës, anëtarët e Këshillit Kombëtar me banim në degë, sekretari i Diasporës për Degën, Kryetarët e Bashkisë dhe/ose Kryetarët e Këshillit Bashkiak, kur i përkasin PD, si dhe këshilltarët bashkiak të PD.”.

b) Fjalja e parë, e shkronjës “c”, të pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

”Numri i grave dhe vajzave fituese të jetë gjer në 40 % të numrit të anëtarëve të Kryesisë që del prej votimit.”.

c) Në pikën 3, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

”g. propozon ngritjen e NënDegëve në territorin që mbulon Dega, duke përcaktuar edhe kufinj të mbulimit për secilën NënDegë.”.

d) Në fund të pikës 5, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

”Kolegji i kryetarëve të grupseksioneve, në varësi të tematikave që diskutohen në mbledhjen e Kryesisë së Degës, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Kryesisë, rast pas rasti apo në mënyrë të përhershme, si anëtar pa të drejtë vote.”.

Neni 10

Pas nenit 34, shtohet neni 34/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 34/1

Sekretari i Diasporës në degët e PDSH-së

1. Në çdo degë të PDSH-së krijohet funksioni i Sekretarit të Diasporës së Degës.
2. Sekretari i Diasporës së Degës zgjidhet nga Kryesia e Degës, sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.
3. Sekretari i Diasporës së Degës ka për detyrë:
 - a) të identifikojë anëtarët, simpatizantët dhe votuesit e PDSH-së që jetojnë jashtë vendit dhe kanë lidhje territoriale me degën përkatëse;
 - b) të bashkërendojë komunikimin ndërmjet degës në Shqipëri dhe strukturave të PDSH-së jashtë vendit;
 - c) të ndihmojë procesin e informimit, regjistrimit dhe mobilizimit elektoral të shtetasve shqiptarë jashtë vendit;
 - ç) të raportojë periodikisht pranë Kryesisë së Degës mbi ecurinë e procesit të identifikimit dhe realizimin e objektivave.
4. Çdo degë e PDSH-së përcakton objektiva periodike për identifikimin, kontaktimin dhe mobilizimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, sipas udhëzimeve të organeve qendrore të PDSH-së.”.

Neni 11

Pika 2, e nenit 38, shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 40, bëhen këto ndryshime:

- a) Fjalja e dytë ndryshon si më poshtë vijon:

“Në këtë rast, drejtimin e degës e bën një nga Nënkryetarët e caktuar nga Kryesia e PDSH-së, për aq kohë sa zgjat pezullimi i Kryetarit.”.

- b) pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Pezullimi i kryetarit sipas pikës 1, nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë. Në rast se rrethanat diktojnë që pezullimi është i nevojshëm për një kohë më të gjatë, atëherë Kryesia e PDSH procedon me shkarkimin e Kryetarit të Degës, dhe

komandimin e një kryetari të ri në detyrë deri në organizimin dhe përfundimin e zgjedhjes së Kryetarit të ri sipas rregullave të këtij Statuti.”.

Neni 13

Në fund të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 42, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Organizatat e tjera partnere përfaqësohen me një numër delegatësh gjer në 2 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, sipas numrit konkret që njoftohet nga Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së.”.

Neni 14

Në nenin 44 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 2, togfjalëshi “dhe 150 anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë”, zëvendësohet me togfjalëshin “dhe 200 anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë”.
- b) Në fjalinë e dytë, të pikën 2, togfjalëshi “, si dhe një numër i barabratë me 10 % të anëtarëve të zgjedhur, të cilët vijnë si propozime nga diaspora dhe emigracioni”, zëvendësohet me togfjalëshin “, si dhe një numër gjer në 15 % të anëtarëve të zgjedhur, të cilët vijnë si propozime nga diaspora dhe/ose Degët e PD jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.
- c) Në fjalinë e katërt, të pikës 3, togfjalëshi “nga gjinia më pak e përfaqësuar nuk duhet të jetë më pak se 30 %”, zëvendësohet me togfjalëshin “nga gjinia më pak e përfaqësuar duhet të jetë gjer në 40 %”.

Neni 15

Në nenin 45, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “d/1”, me përmbajtje si më poshtë vijin:

“d/1. Mban qëndrimin e partisë lidhur me rezultatin e zgjedhjeve të përgjithshme apo lokale, si dhe shkallën e respektimit të standradeve të zgjedhjeve të lira e të ndershme. Qëndrimi i Këshillit Kombëtar ka efekt të menjëhershëm dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha organet drejtuese të Partisë Demokratike. Ai ratifikohet në mbledhjen më të parë të Kuvendit Komëbtar të PDSH-së.”.

Neni 16

Në nenin 46, pika 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Kur Kryetari mungon përkohësisht në detyrë, ai zëvendësohet nga një prej Nënkryetarëve të caktuar me delegim nga Kryetari.”.

Neni 17

Në nenin 47, bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronja “e”, e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:
”e. kryetarët e organizatave partnere të Partisë Demokratike;”.
- b) Shkronja “f”, e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:
”f. Dy anëtarë, përfaqësues të Diasporës, të cilët propozohen nga Kryetari i Partisë dhe caktohen nga Kryesia e PDSH menjëherë pas konstituimit të saj.”.
- c) Në fjalinë e dytë të shkronjës “g”, togfjalëshi “Jo më pak se 30 % e anëtarëve”, zëvendësohet me togfjalëshin “Deri në 40 % e anëtarëve”.

Neni 18

Shkronja “a” e paragrafit të dytë, të pikës 1, të nenit 48, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a. emëron sekretarët politik të Degëve të PDSH-së, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 19

Pas nenit 51, shtohen nenet 51/1 dhe 51/2, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 51/1

Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH

1. Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH, përbëhet nga të gjithë Kryetarët dhe Sekretarët Politik të Degëve të PDSH, dhe është një strukturë drejtuese ndihmëse dhe këshillimore e Kryetarit të Partisë.
2. Kolegji i Drejtuesëve të Degëve të PDSH, ushtron këto përgjegjësi:
 - a) diskuton mënyrën e përmbushjes së detyrave në kuadër të një aksioni apo aktiviteti politik, sipas vendimeve të marra nga organet drejtuese të PDSH-së;
 - b) këshillon Kryetarin e Partisë për ndërmarrjen e aksioneve politike dhe iniciativave që sigurojnë mbarëvajtjen e punës në parti;
 - c) mbështet Kryetarin e Partisë në përmbushjen e detyrave të caktuara nga organet drejtuese të partisë;

d) diskuton për format dhe mënyrat e përmirësimit të organizimit dhe punëve në parti.

Neni 51/2

Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës

1. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës është organ konsultativ dhe përfaqësues i diasporës, që ngrihet dhe funksionon pranë Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë.

2. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës drejtohet nga Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe ka në përbërje:

- a) Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së;
- b) Të gjithë kryetarët e degëve të PDSH-së në diasporë;
- c) Drejtuesit e Sekretariatit për Diasporën i PDSH-së;
- d) Sekretari i Marrëdhënieve Ndërkombëtare i PDSH-së;
- e) 5 deri në 7 personalitete të shquara shqiptare të diasporës, të cilët emërohen me propozim të Kryetarit të Partisë pas miratimit nga Kryesia e PDSH-së.

3. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës ushtron këto përgjegjësi:

- a) propozon strategjinë kombëtare të PDSH-së për diasporën;
- b) bashkërendon organizimin e degëve dhe strukturave të PDSH-së jashtë vendit;
- c) propozon kandidatura dhe personalitete të diasporës për përfaqësim në organet e PDSH-së dhe në listat elektorale;
- ç) bashkërendon kontributin e profesionistëve, akademikëve, sipërmarrësve, studentëve dhe personaliteteve të diasporës në programet politike të PDSH-së;
- d) konsulton Kryesinë e PDSH-së duke i paraqitur asaj raporte periodike mbi gjendjen organizative, anëtarësinë, simpatizantët, nivelin e mobilizimit dhe problematikat e diasporës.

4. Këshilli Koordinues Kombëtar i Diasporës mbledhet jo më pak se një herë në vit. Ai mund të mbledhet edhe jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Partisë.

5. Organizimi, procedurat e funksionimit, mënyra e raportimit dhe marrëdhëniet e Këshillit Kombëtar të Diasporës me organet e tjera të PDSH-së përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të PDSH-së.”.

Neni 20

Në nenin 58, bëhen këto ndryshime:

- a) Fjalja e dytë, e pikës 3, ndryshon si më poshtë vijon:

“Përfaqësimi i LDG shkon gjer në 40 %, përvec rasteve kur ligji elektorale përcakton një standard minimum më të lartë.”.

b) Fjalë e fundit, e pikës 3, ndryshohet si më poshtë vijon:
“Përfaqësimi i organizatave të tjera partnere përcaktohet nga Kryesia e PDSH-së dhe mund të shkojë gjer në 2 %. Kandidaturat propozohen në bashkëpunim dhe pasi është marrë mendimi i organizatave partnere.”.

Neni 21

Në nenin 60, pas togfjalëshit “Kuvendit Kombëtar”, shtohen togfjalëshi “, Kryesisë së Partisë”.

Neni 22

Në nenin 61, togfjalëshi “ të dala nga zgjedhjet e ardhëshme pas ristrukturimit të PD,”, hiqet.

Neni 23

Këto ndryshime të Statutit, hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar, më ____/____/2026

**KOMISIONI I DREJTIMIT TË PUNIMEVE TË KUVENDIT
KOMBËTAR:**

KRYETARI

ANËTAR

ANËTAR

ANËTAR

ANËTAR